



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24-37/2018 regjistër (JR)  
Datë 17.12.2024

Nr. 66 i vendimit  
Datë 24.03.2026

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 24.03.2026, ditën e martë, në orën 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen që i përket:

**KËRKUES:** Dritan Rreshka, lindur më {\*\*\*}, banues në rruga “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, Tiranë.

**OBJEKTI:** Rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 6, pika 1 e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; vendimet e GjEDNj-së për çështjet “Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë”, “Besnik Cani kundër Shqipërisë”, “Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës”; nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 6/2006, nr. 9/2010 dhe nr. 20/2011; nenet 494, 495, 496, 497, 498 dhe 498/a të Kodit të Procedurës Civile; neni 15, pika 1, germa “c” e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.07.2017, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, e ndryshuar.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi pretendimet në kërkesën dhe parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Dritan Rreshka (në vijim “kërkuari”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) me vendimin nr. 55, datë 31.07.2018, ka vendosur *shkarkimin e tij nga detyra*. Pasi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi shkaqet e ankimit të pretenduaras prej subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, Kolegji vendosi *lënien në fuqi të vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka*.
2. Kërkuari ka paraqitur në Kolegji, kërkesë për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.

2.1. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë të datës 18.11.2024, gjyqtarin A. H., ish anëtar i trupit gjykues së çështjes së tij të rivlerësimit në Kolegji. Në këto rrethana, pas dhënies dhe publikimit të vendimit të kësaj gjykate, kërkuari kërkoi rihapjen e çështjes për shkak të emërimit të paligjshëm të ish-anëtarit të Kolegjit, z. A. H., i cili ka qenë pjesë e panelit që shqyrtoi çështjen e tij, në kundërshtim dhe në shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ-së që parashikon të drejtën për një gjykim të drejtë në lidhje me gjykatën e krijuar me ligj. Kërkuari e bazon këtë pretendim në nenin 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile. Ai, po ashtu, shprehet se ka qenë e pamundur të ishte në dijeni të këtij fakti dhe ka marrë dijeni vetëm pas shkarkimit të gjyqtarit A. H. nga detyra nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

2.2. Shkaku i dytë i kërkesës ka të bëjë me parashikimin e nenit 494, germa “e” të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, i cili është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë, me të njëjtat palë ndërgjyqëse, të njëjtin objekt, dhe për të njëjtin shkak. Kërkuari pretendon se nën dritën e vendimit të GjEDNJ-së për çështjen “Dedja kundër Shqipërisë” dhe rëndësisë që Gjykata i kushtoi mosdeklarimit nga ankuesi të një pasurie në atë rast, arsyeja kryesore që çoi në refuzimin e kërkesës së tij, ishte miratimi i GjEDNJ-së për konstatimin e Kolegjit se aplikuesi dhe njëkohësisht ish-subjekti i rivlerësimit kishte kryer fshehje pasurie. Kërkuari argumenton se, në të njëjtin vendim, gjykata la të hapur çështjen nëse vepra penale e parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal është e njëjtë, ashtu si dhe në ligjin e *vetting*-ut, i cili vetë është bazuar në ligjin nr. 9049/2003.

2.3. Pas konkluzionit të Kolegjit, se kërkuesi ka kryer fshehje pasurie, ILDKPKI-ja ka bërë kallëzim penal ndaj tij për dyshimet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mosfillimin e hetimeve në lidhje me kallëzimin e depozituar nga ILDKPKI-ja. Nga ankimi i ushtruar nga ILDKPKI-ja ndaj këtij vendimi të Prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur se, referuar provave të administruara, nuk ka të dhëna ose prova që sugjerojnë kryerjen e ndonjë veprës penale nga Dritan Rreshka. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.10.2024, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas të cilit kallëzimi i ILDKPKI-së është i pabazuar në ligj. Në këto rrethana, kërkuesi argumenton se nuk ka asnjë hije dyshimi që nga ana e tij të jetë kryer ndonjë veprë penale që ka lidhje me fshehjen e pasurisë. Si rrjedhojë, konkluzioni i Kolegjit për fshehje pasurie nuk mund të përbëjë shkelje me natyrë administrative, por shkelje me natyrë penale ose veprë penale, në rastet kur konstatohet kryerja e tyre.

2.4 Kërkuesi pretendon se kjo situatë e vendos në kushtet e nenit 494, germa “e”, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit vendimi për të cilin ai kërkon rishikimin, është në kundërshtim të hapur me një vendim të tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt, dhe për të njëjtin shkak. Në këtë situatë, konkluzionet e vendimit nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, nuk janë të drejta, provuar me vendimet e gjykatës të cituara më lart, e për pasojë, ky vendim duhet të rishikohet. Në përfundim, z. Dritan Rreshka kërkon rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, dhe prishjen vendimit nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe vazhdimin e gjykimit në themel të çështjes në seancë publike.

2.5 Bashkëngjitur kërkesës për rishikimin të vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi ka bashkëngjitur si në vijim:

- i. Formular deklarimi të pasurisë për subjektin e rivlerësimit Dritan Rreshka, depozituar pranë ILDKPKI-së me nr. 08109, datë 21.06.2007.
- ii. Vendimi nr. 20, datë 01.06.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
- iii. Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 12.01.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

## **II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

### *A. Procesi gjyqësor në Kolegj*

#### *Juridiksioni i Kolegjit*

3. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu sipas pikës 3, të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe

Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

4. Në vijim të sa më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur [literal], *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi. *Së dyti*, kuadri ligjor në fjalë nuk parashikon asnjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
5. Duke konfirmuar të njëjtën linjë arsyetimi sikurse në vendimin e tij të mëparshëm, me nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y., trupi gjykues i Kolegjit rithekson edhe në këtë rast në mënyrë të përmbledhur atë qëndrim për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kushtetutës, të nenit F të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, kundrejt juridiksionit rishikues të vendimeve të formës së prerë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Konkretisht, nga leximi harmonik i këtyre rregullimeve, për sa i përket juridiksionit rivlerësues e rishikues të Kolegjit, trupi gjykues vëren se në to parashikohet në mënyrë të shprehur vetëm juridiksioni rivlerësues i Kolegjit, në funksion të kontrollit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në ankimet e subjekteve të rivlerësimit apo ato të ushtruara nga Komisionerët Publikë. Në linjë me arsyetime të mëparshme të Kolegjit, nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave, diktoi nevojën e analizimit të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016.
6. Në linjë me sa argumentuar në vendime të mëparshme të Kolegjit me objekt rishikime vendimesh të formës së prerë, edhe në këtë rast vërehet se gjen zbatim konstatimi se ndër tagrat e përcaktuara nga Kushtetuta e ligji për Kolegjin, nuk përfshihet juridiksioni rishikues. Po ashtu, pa përsëritur sa është referuar më parë, Kolegji nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. Procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, dhe leximi harmonik i nenit F, pika 8<sup>1</sup> e Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile<sup>2</sup>, çon në konkluzionin se i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre, është kontrolli që ushtron GjEDNj-ja. Për rrjedhojë, një vendim i GjEDNj-së që konstaton një shkelje të kryer në çështjen e një ankuesi konkret, konsiderohet edhe e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar.
7. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në

<sup>1</sup> Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>2</sup> “[...] Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur: [ë] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”

ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit, është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë.

8. Nga ana tjetër, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkuarit. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm, zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivitetit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezulton edhe nga mënyra sesi është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, lexuar në harmoni me pikën 8 të Nenit F të Aneksit të Kushtetutës.
9. Nga sa më sipër, rezulton se, në kushtet që për kërkuarin nuk ka një vendim nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja të ketë konkluduar një shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të tij, kërkesa për rishikim e ushtruar nga kërkuari, nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit sipas pikës 8 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 494 germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile.
10. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuarit, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim. Kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuari bën në nenin 494, germat “a” dhe “e” të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës<sup>3</sup> së Kolegjit, trupi gjyqësor vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Për pasojë, kjo kërkesë konsiderohet nga trupi gjyqësor si e papranueshme. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
11. Pavarësisht dhe duke abstraguuar nga sa më sipër, trupi gjyqësor i Kolegjit çmon të shtojë si *obiter dictum*, se shkaqet e parashtruara si bazë për kërkesën për rishikim, edhe nëse do t’i nënshtroheshin shqyrtimit, do të konstatoheshin të pabazuara, vlerësuar nën dritën e të dy dispozitave dhe shkaqeve ligjore të parashtruara prej tij. Konkretisht, për sa i përket kontekstit

---

<sup>3</sup> Vendimi nr.12, datë 19.04.2024 i Kolegjit që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y.; Vendimi nr. 9, datë 28.02.2025 i Kolegjit që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit A. B.; Vendimi nr. 10, datë 28.02.2025 i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuarit B. M..

të dënimit penal të dhënë në ngarkim të gjyqtarit A. H., trupi gjykues çmon, së pari, të theksojë se vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Së dyti, në linjë me arsyetimin e Kolegjit për kërkesat për rishikim, duke marrë si shkas dënimin penal të një gjyqtari tjetër, -- kërkesat për rishikim të kërkuases R. G. -- në mënyrë që dënimi penal i dhënë ndaj një anëtari të trupit gjykues të përbëjë provë të re, sipas germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për rishikim të një vendimi të formës së prerë, kushtëzohet nga përmbushja e kriterit sipas të cilit zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj. Përndryshe, ky mjet ligjor mund të kishte pasoja joproduktive në menaxhimin e ngarkesës së punës në gjykatë, sikurse edhe vendoste parimin e *res judicata* në pozitë të përhershme vulnerabiliteti. Me fjalë të tjera, në mënyrë që mjeti i jashtëzakonshëm t’u shërbejë interesave të drejtësisë, pa cenuar në tërësi parimet e përgjithshme themelore të saj [drejtësisë], risitë që vijnë nga provat e rrethanat e tjera, duhet të jenë të atilla që drejtësia e vendosur të prevalojë kundrejt sigurisë juridike që cenohet apo ekonomisë gjyqësore [drejtësisë së dhënë pa vonesë], që shoqëron si pasojë riçeljen e një çështjeje për shkak të rishikimit.

12. Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së, se parimi i “gjësë së gjykuar” nënkupton që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore, një rishqyrtim dhe një rigjykim të çështjes. Kompetencat për rishikim të gjykatave më të larta, duhen ushtruar për korrigjimin e gabimeve gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë, jo për të kryer një gjykim të ri të çështjes. Rishikimi nuk duhet trajtuar si një apel i fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistencës së pikëpamjeve të ndryshme në lidhje me objektin e gjykimit, nuk përbën bazë për rishqyrtim. Anashkalimi i këtij parimi justifikohet vetëm kur bëhet i nevojshëm nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese. Ky aspekt paraqet rëndësi në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”<sup>4</sup>.
13. Së dyti, në mënyrë që dënimi penal të përbëjë provë të re, do të duhet të thirret në analizë edhe vepra penale. Me fjalë të tjera, që vendimi penal në vetvete të përbëjë shkas për rishikimin e vendimit [sipas nenit 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile], pala kërkuese duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të atakuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari/gjyqtarja ka marrë vendimin, vullneti i tij/saj është vesuar për shkak të një veprë penale, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. E thënë ndryshe, duhet të ketë një lidhje shkakësore mes sjelljes së papërshtatshme, ndikimit të paligjshëm apo një veprimi tjetër volutiv të gjyqtarit dhe vendimit për të cilin kërkohet rishikim. Në asnjë prej rrethanave të parashikuara si shkak për rishikimin, ligji nuk u referohet ndodhive, fakteve apo rrethanave të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë apo janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi, për një problematikë dhe ngjarje të cilat nuk kanë asnjë lidhje shkakësore me vendimin e themelit për të cilin kërkohet rishikim.

---

<sup>4</sup> Referencë vendimi i Kolegjit për kërkesat për rishikim të vendimit të Kolegjit nga kërkuësja R. G., ndër të tjerë në paragrafët 14.4 dhe 14.5. [https://kpa.al/ep-content/uploads/2024/11/Vendimi\\_Rovena\\_Gashi\\_perفشیره\\_mendimin\\_paralel\\_anonimizuar.docx-1.pdf](https://kpa.al/ep-content/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perفشیره_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf)

14. Shkaku tjetër i potencuar në kërkesën për rishikim, merr shkas nga konfirmimi në Gjykatën e Apelit i vendimit të prokurorisë për mosfillim të hetimeve mbi bazën e kallëzimit penal të ushtruar në ngarkim të kërkuesit. Edhe në këtë këndvështrim, kjo kërkesë është e pabazuar, porë në disa kontekste. Së pari, procesi i rivlerësimit është i një natyre të posaçme, dhe fakti që prokuroria ka vendosur mosfillim, i cili është lënë në fuqi nga gjykatat, nuk do të passillte efekt mbi një vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Prosesi i rivlerësimit, jo vetëm nuk mbivendoset apo konkurren me procese të tjera, por duke qenë administrativ, ka një natyrë të ndryshme e i nënshtrohet parimeve të ndryshme procedurale.
15. Në këtë linjë, dhe si vijim i *obiter dictum*-it sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe faktin që masa disiplinore e shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, tashmë në cilësinë e kërkuesit, ka pasur në konsideratë konkluzione që kanë rezultuar nga aspekte përtej atyre të marra në shqyrtim nga prokuroria e gjykatat në vendimmarrjen për mosfillimin e hetimit. Vendimet e parashtruara si shkak për të argumentuar zbatimin e germës “e” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, nuk përmbushin asnjë nga kriteret për ta vendosur vendimin e Kolegjit në të një plan në të cilin do të mund të kryhej krahasim. Kërkuesi në thelb pretendon se vendimi i Kolegjit është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Kërkuesi potencon se një kallëzim penal i mosfilluar, për të cilin gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë rënë dakord me prokurorin për të mos kryer hetim, në një procedim penal, përbën “vendim gjyqësor për të njëjtin objekt dhe me të njëjtat palë dhe të njëjtin shkak” në një vendim të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, dhomë e Gjykatës Kushtetuese në një proces me natyrë administrative.
16. Ky paralelizëm është tërësisht i pabazuar. Ndërsa, nga njëra anë, rrethanat e sjella në vëmendje të Kolegjit prej kërkuesi janë të krijuara pasi është marrë vendimi përfundimtar për të cilin kërkohet rishikim, nga ana tjetër, ato fokusohen në kontrollin e një vendimi procedural të prokurorisë, për fakte penale të kallëzuara. Përkundër këtyre rrethanave, trupi gjykues i Kolegjit ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuesit, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, kundër një mase disiplinore të marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pas një hetimi administrativ. Me fjalë të tjera, jo vetëm sepse mosfillimi i një procedimi dhe dakordësia e gjykatës me këtë vendim procedural të prokurorit nuk përbën vendim gjyqësor të natyrës së themelit, por mbi të gjitha, as objekti dhe as palët nuk janë të njëjta. Së fundmi, por jo nga rëndësia, kërkuesi ka marrë masën e shkarkimit nga detyra për disa aspekte të vlerësimit të pasurisë, përfshirë fshehjen e pasurisë<sup>5</sup>, deklaram të rremë për koston e ndërtimit dhe mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e një pasurie të paluajtshme, sikurse edhe për krijimin e një pasurie të luajtshme. Nga gjithë këto kontekste, pretendimi se gjen zbatim germa “e” e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, është i pabazuar.
17. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se, kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Dritan Rreshka është e pabazuar në fakte dhe në ligj, dhe si e tillë, ajo nuk mund të pranohet.

---

<sup>5</sup> <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

**VENDOSI:**

Mospranimin e kërkesës së kërkesit Dritan Rreshka, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 15, datë 17.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e kryesueses, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 66, datë 24.3.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Dritan Rreshka për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 15 (JR), datë 17.07.2019, të Kolegjit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës, por kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimin të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues<sup>6</sup> të Kolegjit për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494<sup>7</sup>, shkronja “c”<sup>8</sup> të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente në një sërë vendimesh ku janë shqyrtuar kërkesat për rishikim vendimi, duke mbajtur një qëndrim ndryshe, shprehur nëpërmjet mendimeve paralele<sup>9</sup> apo mendimeve të pakicës<sup>10</sup>.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të

---

<sup>6</sup>Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupës gjyqësore në vendimin nr. 12, datë 19.4.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjyqësor.

<sup>7</sup>Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: ë...](c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjyqësor, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ë...](ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

<sup>8</sup> Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarit R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

<sup>9</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.2.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B.; Vendimi i Kolegjit nr. 18, datë 8.5.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj., etj.

<sup>10</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 19, datë 08.05.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit R. T.; Vendimi i Kolegjit nr. 49, datë 11.03.2026, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit B. H.; Vendimi i Kolegjit nr. 54, datë 24.03.2026, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit G. T. etj.

posaçëm për kërkuesin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjete i brendshëm të mos jetë efektiv<sup>11</sup> dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13<sup>12</sup> të KEDNJ-së.

5. Në lidhje me kërkesën e kërkuesit Dritan Rreshka, paraqitur më datë 17.12.2024, rezulton ndër të tjera se: (i) shkak për rishikim, sipas pretendimit të kërkuesit përbën vendimi gjyqësor i shpallur më datë 18.11.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {\*\*\*}, që ka dënuar me vendim të formës së prerë<sup>13</sup> gjyqtarin A. H.; (ii) prania z. A. H. në trupin gjykues që ka shqyrtuar vendimin e dhënë nga Komisioni ndaj kërkuesit përbën shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ-së dhe të gjykatës së krijuar me ligj; (iii) gjyqtari A. H. nuk plotëson kriteret e nevojshme ligjore për t'u emëruar (referuar vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2/2011); (iv) kërkesa, referuar nenit 494, germa “a” dhe “e” të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimeve të GJEDNJ-së në çështjet: *Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë, Besnik Cani kundër Shqipërisë dhe Dedja kundër Shqipërisë*, përbën shkak për rishikim dhe prishjen e vendimit të formës së prerë nr. 15 (JR), datë 17.07.2019.
6. Sa i përket kësaj kërkesë, vlerësoj se kërkuesi i është referuar vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili edhe pse është një vendim i formës së prerë, nuk përbën një vendim përfundimtar, në kuptim të *res judicata*. Nga burime të hapura, rezulton që ky vendim të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë, e cila ende nuk ka mbajtur një qëndrim për rekursin.
7. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 2, datë 03.11.2014, në trajtimin e çështjes së referuar, i kanë bërë një interpretim të qartë e të plotë kuptimit që duhet të ketë termi “vendimi i formës së prerë”, për efekt të gjësë së gjykuar, duke plotësuar mungesën e një përkufizimi juridik të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me shprehjen “*vendim i formës së prerë*” dhe se si duhet të konsiderohen nocionet “*vendim i ekzekutueshëm*”, “*vendim i formës së prerë*” dhe “*gjë e gjykuar*”. Kështu, në paragrafin 26 të vendimit, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se: “26. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet rikonfirmuar pohimi sipas të cilit rekursi në Gjykatën e Lartë përbën mjet të zakonshëm ankimi, shterimi i të cilit e kthen vendimin në formë të prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar [...]”.
8. Referuar vendimmarrjes unifikuese që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sa kohë që ndaj rekursit të gjyqtarit A. H., deri në momentin e gjykimit të kësaj kërkesë, nuk ka ende një vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që të ketë shteruar rekursin, si mjet të zakonshëm ankimi, për pasojë, dënimi penal nuk ka marrë formë të prerë në kuptim të “gjësë së gjykuar”.

---

<sup>11</sup> Çështja “*Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. 36813/97)*” - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925>.”

<sup>12</sup> Neni 13 i KEDNJ-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

<sup>13</sup> Gjyqtari A. H. është dënuar për veprat penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga nenet 180 dhe 257/a të Kodit Penal.

9. Në këto kushte, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi, e bazuar në një vendim të Apelit, që nuk ka marrë formë të prerë, në kuptim të “gjësë së gjykuar”, në koherencë me qëndrimet e mia të mëparshme, vlerësoj se nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë nga ana formale, sipas parashikimeve të nenit 495 të Kodit të Procedurës Civile.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 66 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *“Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Dritan Rreshka, për rishikimin e vendimit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë sui generis, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, e bën të pabazuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkuari.*
2. Në cilësinë e gjyqtare me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarës, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”.*
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane ‘Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore’ dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.*
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t'i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimit të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*